



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:124415
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05653965

Ac.nr.7364/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Liridon Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve A.R, A.R, A.R, K.R dhe K., të cilët i përfaqëson me autorizim avokati Sh.I, kundër debitorit Korporata ENergjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, PPP.nr.97/19, të datës 13.02.2020, me datën 03.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e debitorit Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, PPP.nr.97/19, të datës 13.02.2020, dhe çështja kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.97/19, të datës 13.02.2020, e ka refuzuar prapësimin e debitorit Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.185/19 e dt.24/05/2019 dhe mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.185/19 e dt.24/05/2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtuar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 dhe nenin 209 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 24.05.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Përmbaruesi Privat, me urdhrin P.nr.185/19 e datës 24/05/2019, e ka lejuar përmbarimin e propozuar në bazë të dokumentit përmbarimor-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.0138/12 e datës 05/08/2013 i cili aktgjykim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.2192/14 e datës 15/03/2019 sa i përket kamatës dhe është bërë i plotfuqishëm me datën 15/03/2019 dhe i ekzekutueshëm me datën 23/05/2019. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore nga neni 181 par.1 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 21 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ekzistojnë shkelje procedurale të lartcekura, ngase gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk e ka shqyrtuar me kujdes të shtuar prapësimin e debitorit në raport me shkresat e lëndës, pasi që dokumenti përmbarimor i parasheh shumat e gjykuara të kompensimit të dëmit në lartësi të përgjithshme prej 26,700 euro, me kamat të gjykuar sipas mjeteve të deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat me tepër se një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 05/08/2013 e deri në pagesën definitive, ndërsa përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditorët për shumën 28,500.00 euro (e cila shumë nuk përputhet me shumën e gjykuara për kategoritë e dëmit material dhe jo material si në dokumentin përmbarimor) e të cilën kundërshtim të debitorit, gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka shqyrtuar, përveç kësaj, ajo e vlerëson si të ligjshëm urdhrin përmbarimor mbi lejimin e përmbarimit të propozuar edhe sa i përket llogaritjes së kamatës së gjykuar e cila kamat kërkohet në lartësi prej 8 % prej datës 24/05/2019 e deri në pagesën definitive, prandaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk e ka pasur parasysh nenin 21 të LPP-së e cila dispozitë shprehimisht parasheh: *Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*. Përmbaruesi privat F.H, po ashtu me shënimin zyrtar P.nr.185/19 e datës 18/06/2019, e ka përmisuar urdhrin P.nr.185/19 e datës 24/05/2019, për shkak të lëshimeve teknike në dokumentin përmbarimor, por gjykata e shkallës së parë as këtë fakt nuk e merr parasysh dhe e len në fuqi urdhrin P.nr.185/19 e datës 24/05/2019, me të cilin lejohet përmbarimi i propozuar nga kreditori e cila lartësi monetare nuk është në harmoni me dokumentin përmbarimor. Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që fillimisht të vlerëson nevojën për korrigjimin e dokumentit përmbarimor, pastaj të vlerëson nevojën për caktimin e seancës publike dhe palët të deklarohen lidhur me korrigjimin e dokumentit përmbarimor dhe urdhrin përmbarimor, propozimin për përmbarim si dhe lidhur me prapësimin e debitorit dhe të vendos brenda kufijve të dokumentit përmbarimor si dhe të vlerësoj të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Numri i lëndës: 2022:124415
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05653965

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (d) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.7364/22, me datë 03.05.2024

Gj y q t a r i
Liridon Maloku